

Home &gt; Kronikë

## Policia në kërkim të 32-vjeçarit që terrorizoi Beratin, zbrazti dy karikatorë kallashnikovi

— 18/10/2019 15:47


[Shperndaj ne Facebook](#)
[Shperndaj ne Twitter](#)


Berati është zgjuar sot nën breshëritë e automatikut, duke iu risjellë në kujtesë qytetarëve vitin e errët të 1997. Një 32-vjeçar nga Berati, pas një konflikti për motive të dobëta me shtetasin A.F. në një lokal të qytetit, ka marrë një kallashnikov dhe është kthyer për ta qëlluar.

Por, pasi nuk e ka gjetur personin me të cilin kishte debatuar, 32-vjeçari Krios Vangjeli, ka zbrazur në ajër 2 karikatorë kallashnikovi, duke terrorizuar gjithë qytetin. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 01:30 minuta në Bulevardin "Republika" të qytetit dhe menjëherë pas të shtënave me armë, policia ka shkuar në vendngjarje, ku kanë gjetur vetëm gëzhhojat e armës "kallashnikov".

Pas pyetjes së dëshmitarëve në vendngjarje dhe pas sekuestrimit të kamerave të sigurisë të bizneseve përgjatë Pedonales, policia arriti të identifikojë autorin e ngjarjes, 32-vjeçarin Krios Vangjeli. Ai është shpallur në kërkim nga policia, e cila po kontrollon zonën përreth dhe banesat në të cilat mendohet se është fshehur për të bërë arrestimin e tij. Burime konfidenciale kanë deklaruar se konflikti mes dy të rinjve ka ardhur gjatë një loje "pokeri" mes tyre.

### Informacion paraprak

Gjatë natës rreth orës 01:30 në Bulevardin "Republika" pas një konflikti për motive të dobëta midis shtetasve A.F dhe K.V, banues në Berat, ky i fundit dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në ajër dhe më pas është larguar nga vendi ngjarjes. Shtetasi K.V është shpallur në kërkim dhe po punohet për kapjen e tij. Grupi hetimor dhe shërbimet e policisë po punojnë për zbardhjen e rrethanave të ngjarjes.